



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

APS.nr.7/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi – kryetar, Bashkim Hyseni dhe Ferit Osmani – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në lëndën penale ndaj të akuzuarve: B.B, M.K-L, N.R dhe D.G, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, e akuzuara F.H për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 KPRK dhe i akuzuari A.Gj për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të ushtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti Special në Prishtinë PS.nr.17/2020 i datës 07.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.17/2020 i datës 07.11.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

1. Historiku i çështjes

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me aktgjykimin PS.nr.17/2020 e datës 07.11.2022, të akuzuarit B.B, M.K-L, N.R dhe D.G, për shkak të veprës penale keqpërdorim i

pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuarën F.H për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 KPRK dhe të akuzuarin A.Gj për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 KPRK-së, konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së i ka liruar nga akuza.

Bazuar në nenin 454 të KPPRK, shpenzimet e kësaj procedure penale bien në barrë të mjeteve buxhetore pasi që të akuzuarit janë liruar nga akuza.

Bazuar në nenin 463 të KPPRK, e dëmtuara Korporata Energjetike e Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes se ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykim e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit B.B, av.Besnik Berisha, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj ankesën si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit M.K, av.Florent Latifaj, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj ankesën si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarës F.H, av.Artan Qerkini, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj ankesën si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A.Gj, av.Flamur Bllacaku, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj ankesën si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/L.nr.68/2023, datë 01.02.2023 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigjet në ankesë të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve B.Bj, av.Besnik Berisha, M.K, av.Florent Latifaj, F.H, av.Artan Qerkini dhe A.Gj, av.Flamur Bllacaku të refuzohen si të pa bazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-të, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues, palët nuk u njoftuan për seancën e kolegjit.

2. Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale

Prokurori i Prokurorisë Speciale në ankesë, thekson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të dispozitave të lartshënuara, është i pakuptueshëm, kundërthënës dhe nuk përmban arsyet për faktet vendimtare, po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të duhura për faktet vendimtare.

Në arsyetimin e gjykatës, theksohet se me asnjë provë të vetme organi akuzues nuk ka potencuar apo vërtetuar se cili akt ligjor apo nënligjor është shkelur, kjo nuk qëndron pasi që kjo prokuroria në aktin akuzues e ka potencuar së është shkelur Ligji për rregullatorin e energjisë elektrike nr.05/L-185 për Rregulloren e Energjisë (në fuqi në atë kohë), si dhe janë shkelur Nën-Ligjet dhe Kodi i mirësjelljes datë: 07.12.2009 të cilat burojnë nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/39, dt. 08.10.2008 dhe Vendimi Nr. 02/04, dt. 11.03.2011 me të cilin kanë qenë të përshkruara detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komitetit Qeveritar të Privatizimit (KQP).

Ka shtuar se gjitha dokumentet gjenden në shkresat e lëndës, janë cekur në akuzë dhe po ashtu të njëjtat janë shqyrtuar dhe analizuar edhe në shqyrtim gjyqësor, e për me tepër edhe sikurse mos të ishte cekur fare se cili ligj është shkelur kanë qenë shqyrtimet gjyqësore deri në fjalën përfundimtare, të cilat e kanë shpjeguar në mënyrë kronologjike këtë çështje, prandaj prokuroria është thirrur në këto dy ligje, pasi që ka konsideruar se vepra penale është kryer në mënyrë permanente dhe se këto dy ligje, si ai që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes se veprës penale,

kanë përmbajtje të njëjtë me nenet përkatëse që e rregullojnë çështjen e posedimit me licenca dhe tuje i referohet këtyre ligjeve. Në Ligjin për rregullatorin e energjisë elektrike Nr.05/L-084, neni.35. par.4, shprehimisht thuhet se: "Ndërmarrja e energjisë e cila ka licencë për furnizimin të garantuar të energjisë elektrike nuk mund të aplikoi apo të bartë licence për prodhim apo operim të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe Ligjit Nr. 03/L-185 Për rregullatorin e energjisë nenin.31 par.7, shprehimisht thuhet se: "Ndërmarrja e energjisë e cila ka licencë për furnizimin publik të energjisë elektrike nuk mund të aplikojë apo të bartë licencë për prodhimin apo operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike".

Sipas prokurorisë, arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është joprofesional, sepse kjo gjykatë ka poseduar me të gjithat shkresat e lëndës dhe në ato shkresa kanë qenë edhe dokumentet siç është Kodi i etikës dhe mirësjelljes që buron nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili ka përshkruar edhe të drejtat dhe përgjegjësit e anëtarëve të Komitetit Qeveritar të Privatizimit (KQP), njëra nga përgjegjësit kryesorë ka qenë shqyrtimi dhe aprovimi i të gjitha dokumenteve përfundimtare të projektit përfshire edhe termet e referencës si dhe aprovimin e të gjitha dokumenteve që lidhën me privatizimin e KKDFE-së dhe nënshkrimet e kontratave për shitjen e aksioneve me kompaninë e përzgjedhur gjë që nuk ka ndodhur nga ana e anëtarëve të komisionit.

Duke shtuar se sa i përket pikës së arsyetimit të aktgjykimit se asetet historikisht kanë qenë asete të distribuimit dhe furnizimit e jo të prodhimit, dhe se këto asete kanë kaluar në kompaninë KKDFE me rastin e shthurjes së KEK, duhet të merret në konsideratë fakti se shpërndarja hyn në fazën e privatizimit dhe se KEK – Qeveria e Kosovës, deri në atë moment ka qenë pronare e të gjitha aseteve (100%), qoftë të prodhimi apo shpërndarjes së energjisë elektrike, e pavarësisht regjistrimit të aseteve në divizione brenda organizatës, nuk ka luajtur rol të madh pasi që përfituesi ka qenë vet KEK dhe Qeveria e Kosovës.

Në fazën e procesit të privatizimit ka hyrë vetëm shpërndarja-distribuimi dhe furnizimi, e jo kapacitetet gjeneruese, ku bëjnë pjesë edhe këto katër hidrocentrale, prandaj këto hidrocentrale është dashtë të largohen nga lista e aseteve të shpërndarjes dhe furnizimit pas që të njëjtat kanë gjeneruar energji dhe të mbesin në KEK.

Në mbledhjet e Komitetit Qeveritar të Privatizimit, asnjëherë nuk është diskutuar lidhur me faktin se ekzistojnë edhe katër hidrocentrale të cilat nuk është e lejueshme që të privatizohen, pra këtë çështje e kanë mbajtur në heshtje edhe pse i kanë poseduar të gjitha listat e aseteve të cilat do të

privatizohen, gjë që është dëshmuar edhe me procesverbalet e minutave të takimit të KQP-së, mirëpo edhe vetë të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë pranuar se nuk është diskutuar asnjëherë për këto katër hidrocentrale.

Lidhur me këtë i akuzuari A.Gj në cilësinë e drejtorit menaxhues në KEK dhe e akuzuar F.H në cilësinë e menaxheres se projektit për privatizimit NJIP e kanë ditur se këto asete (Hidrocentrale) janë në listën e aseteve të distribucionit dhe kanë qenë të obliguar që t'ua tërheqin vërejtjen organeve kompetente se ato nuk privatizohen, pra asnjë nga personat të cilët kanë qenë të përfshirë në procesin e privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit nuk kanë marrë asnjë veprim që ti informojnë anëtarët e KQP-ës, se në listën e aseteve kanë qenë të përfshira edhe këto katër hidrocentrale edhe pse të gjithë kanë qenë në dijeni se këto hidrocentrale kanë qenë të përfshira në atë listë dhe se të njëjtat është dashtë që të largohen nga kjo listë dhe të mbesin në KEK.

Përveç kësaj i akuzuari N.R, në deklaratën e tij në Prokurori, deklaroi se në ditën kritike pra më dt. 08.05.2022 ka marrë pjesë dhe ka votuar në takimin e KQP-së, ndërsa gjykata konstaton se i njëjti nuk paska marrë pjesë dhe në bazë të kësaj nuk paska votuar, se ku e bazon këtë konstatim e di vetëm gjykata, ndërsa në anën tjetër anëtarët e KQP-së pavarësisht faktit se a janë informuar apo jo nuk kanë kontrolluar asnjë dokument edhe pse kanë pasur qasje në listat e aseteve të cilat privatizoheshin. Prokurori në ankesë i referohet pjesëve të caktuar të arsyetimit të aktgjykimi të ankimuar duke shtuar se gjykata nuk e përmend faktin vendimtar mendim dhe rekomandim e IFC i cili në faqen 33 në mënyrë precize cek se janë katër hidrocentrale të vogla.....”.

Gjithashtu është i pa qëndrueshëm konstatimi i gjykatës se të akuzuarit nuk kanë pasur qëllim të përfitimit për vete apo ti shkaktojnë dëm dikujt tjetër, pasi që prokuroria për asnjë moment asnjërin nga të akuzuarit nuk e ka akuzuar se kanë përfituar për vete, porse me veprimet e tyre kanë dëmtuar, përkatësisht i kanë mundësuar tjetrit përfitimit, në anën tjetër është pa kontestueshëm se të akuzuari me veprimet e tyre duke vepruar në kundërshtim me detyruat dhe përgjegjësit kanë dëmtuar Qeverinë e Republikë së Kosovës dhe KEK dhe i kanë dhënë mundësi përfitimi privatizuesit që pas përfundimi të koncesionimit këto hidrocentrale të kalojnë në pronësi të plotë të tij.

Përfundimisht, konstatimi se të akuzuarit nuk kanë përfituar asgjë nga ky proces është totalisht konfuz, përveç kësaj aktgjykimi i ankimuar flet për mosekzistimin e bashkëkryerjes, në mënyrë jo

të qartë, sepse edhe shpjegimin e dhënë herë e bazon në një përshkrim që më shumë ka të bëjë me krim të organizuar, e herë duke u lëshuar dhe përsëritur se në xhirollogari të tyre nuk është gjetur asgjë e kundërligjshme, çka është me rëndësi, të kjo pikë janë plotësuar kushtet që parashikohen me ligj, pra ekziston lidhja e caktuar objektive dhe subjektive, pasi që secili prej tyre ka ndërmarrë veprime që kanë qenë të lidhura midis tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë, e që të shkaktohet pasoja e caktuar, dhe si rezultat i përbashkët i veprimeve të gjithë bashkëpunëtorëve, po ashtu lidhja subjektive si kusht ekziston pasi që ligji kërkon të vërtetohet se bashkëpunëtor dinë për njeri tjetrin mirëpo nuk kërkon që ata të njihen me njëri tjetri.

Duke i'u referuar aktgjykimit të ankimuar, thekson se gjykata për të arsyetuar vendin e saj lirues thirret në fjalinë apo pasuese të IFC, mirëpo, do të ishte në rregull nëse pasueset në fjalë do të shpjegohet se çka në të vërtetë është rekomanduar dhe tutje i referohet kësaj marrëveshje të nënshkruar mes Qeveria, Ministrisë së Financave dhe IFC e cila marrëveshje ka përfshirë obligimet e IFC që të kryej studimet e nevojshme për gjendjen reale të kompanisë KEK, studimet në aspektin teknik, logjistik dhe atij mjedisor.

Ndërsa fakti me i rëndësishëm i cili gjendet në shkresat e lëndës ndërlidhet pikërisht me IFC dhe raportet e tyre, rekomandimi në fjalë gjendet në faqen 33 par.2.6; "Janë edhe 4 hidrocentrale të vogla të cilat nuk janë të rëndësishme për KEDS, dhe nuk do të transferohen, këto asete do të mbesin në KEK dhe kufiri komercial di të jetë pika matëse konektuese në bazë të rregulloreve të ZRRE.

Me tej prokuroria shton, se të akuzuarit as që e kanë ditur vlerën e këtyre hidrocentraleve dhe për me tepër i akuzuari Gj., gjatë dhënies së mbrojtjes së tij me datë 19.10.2022 në mes tjerash deklaroi se .."këto katër hidrocentrale kanë qenë të rrënuara, nuk kanë parur ndonjë vlerë....." e që qëllimisht tenton të na vë në lajthitje me fazën e koncesionimit, po në tërësi qëndron konstatimi se këto hidrocentrale, në momentin e privatizimit apo më mirë të themi në momentin e faljes, nuk kanë pasur as vlerë të përcaktuar, e as nuk e kanë marrë për bazë raportin e ekspertit i cili është i bazuar në dëshmitë e ofruara nga koncesionuesit, lidhur me investimet e kryera në këto hidrocentrale, vlera e të cilës dihet saktë, por Gjykata këtë pjesë fare nuk e merr në konsideratë dhe as që lëshohet në arsyetimin e të njëjtës se përse paska ndodhur ky veprim.

Këto katër hidrocentrale, para dhënies më koncesion kanë qenë në gjendje të mjerueshme, me qëllim të rivitalizimit të tyre, të njëjtat janë dhënë me koncesion nga KEK, për periudha të caktuara kohore dhe kontrata janë lidhur për këtë qëllim me KEK-un, që pas përfundimit të periudhës së koncesionimit, të njëjtat të i kthehen vetëm KEK-ut e askujt tjetër, mirëpo kjo rrethanë fare nuk elaborohet nga Gjykata porse vetëm faktin se të njëjtat asetet, thjesht do të kalojnë në pronësi të KEDS, pa asnjë vlerë të përcaktuar, qiraja mujore sot për sot i paguhet KEDS-it, kurse si të tilla, pra të rivitalizuara, përfitimi do të jetë për KEDS, kurse dënimi i shkaktuar KEK dhe aksionares 100 % të saj Qeverisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në ekspertizën financiare dhe e shpjeguar nga eksperti edhe verbalisht, në shqyrtime gjyqësore.

Eksperti financiar, ka shpjeguar në mënyrë kronologjike të gjeturat e tij, të cilat nuk kanë qenë në kundërshtim me pjesën e paraqitur në formë tekstuale dhe me argumente konkrete ka shpjeguar se si ka ardhur deri te fjalja e këtyre katër (4) hidrocentraleve, megjithatë, Gjykata i fali vetëm pjesërisht besimin kësaj ekspertize (vetëm historikut), e pjesës tjetër jo, pastaj në fund të aktgjykimit të ankimuar gjykata vendos që të i udhëzoj në kontest civil e dëmtuara Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht KEK, edhe pse edhe vet potencon se nuk i është shkaktuar ndonjë dëm i pretenduar askujt. Për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

3. Përgjigjet e mbrojtëseve në aneksen e Prokurorisë Speciale

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B, av.Besnik Berisha, në përgjigjen në ankesën, konsideron se ankesa e PSRK-së është tërësisht e pabazuar dhe përmban vetëm përpjekje dhe justifikime për të arsyetuar dështimin e PSRK-së, për një ndjekje penale efektive dhe të bazuar në prova dhe argumente të ligjshme. Për kundër faktit se PSRK si bazë ankimore ka paraqitur shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, e njëjtë është dashur që të përshkruaj dhe elaboroj saktë bazën ligjore, ku ka ngelur e paqartë se në çfarë mënyrë dhe cila normë nga neni 384 të KPP është shkelur nga gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar, në kundërshtim me kërkesat imperative ligjore nga neni 376 dhe 382 par.2 të KPP-së.

Sipas mbrojtjes aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, i njëjti përmban të gjitha faktet vendimtare, aktgjykimi i ankimuar nuk është

marrë me shkelje të ligjit penale si dhe nga i njëjti rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, me rastin e lirimit nga akuza të akuzuarit.

Lidhur me këtë ka shtuar se gjykata e shkallës së parë në faqen 41 të aktgjykimi të ankimuar me të drejtë ka gjetur se pretendimet e organit të akuzës së të akuzuarit kanë vendosur në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Elektrike, respektivisht nenin 35 par. 4 të Ligjit N0.05/L-084, gjykata ka vërtetuar se ky ligj në fjalë është ligj i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën për të cilën organi akuzues pretendon se të akuzuarit kanë kryer veprën penale.

Mbrojtësi më tutje konsideron, se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka bërë analizën e të gjitha provave dhe ka dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare, në rastin konkret nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë pasur qëllim kriminale për kryerjen e veprës penale, nuk ka mundur të faktohet pretendim i prokurorisë se të akuzuarit kanë vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre zyrtare, po ashtu nuk është vërtetuar se nga veprimet e të akuzuarve kanë përfituar ata vet personalisht apo të këtë fituar dikush tjetër, si dhe nuk është vërtetuar fare se ekziston dëm i shkaktuar, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.K, av.Florent Latifaj, në përgjigje në ankesën e PSRK-së, thekson se e kundërshton ankesën e prokurorit të shtetit pasi që konsideron se duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, trupi gjykues në këtë rast penal nuk ka pasur si të vendos ndryshe.

Në këtë rast penal është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor në shumë seanca duke dëgjuar dëshmitarë të shumtë si dhe dëshminë e ekspertit i cili me ekspertizën e vetë ka pretenduar në dëm dhe në përgjegjësi, mirëpo që kjo ekspertizë është dëshmuar të jetë tërësisht e pabazuar dhe e bazuar në pretendime spekulative. Sipas mbrojtjes prokurori ka konstatuar në faqen 13 par.1 i aktakuzës së IFC si ka propozuar që këto asete nuk do te transferohen, por kjo nuk është e vërtetë ngase po i njëjti raport në gjuhën angleze, konstaton se draft ligji nuk ndalon dhe jo ndalon transferin e Hidrocentraleve, e ndërsa në anën tjetër prokurori në gjithë aktakuzën thotë se këto kanë qenë asete të KEDS-it që nga koha kur është nda nga KEK-u.

Duke shtuar se prokurori i rastit i referohet Ligji Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin e Energjisë është ligji i aprovuar me 30.06.2016 gjersa vepra pretendohet se është kryer me 08.05.2013 dhe dispozita juridike e cila pretendon Prokuroria se është cenuar nga e mbrojtura ime ka hyrë në fuqi, afro 3 vite më vonë.

Pretendon përgjegjësi në mënyrë retroaktive duke u bazuar në shpikjen e tij se dëmi është i vazhdueshëm dhe se ai mundet ti referohet cilitdo ligj që i përshtatet, por në fakt ky ligj të cilit i referohet nuk ndalon privatizimin, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarës F.H, av.Artan Qerkini, në përgjigjen në ankesën e PS konsideron se është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor se PSRK pasi që gjatë procesit gjyqësor është mbështetur në dy ligje dhe atë: Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Elektrike Nr.05/L-084 dhe Ligjin Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, mirëpo nëse shikohet akti akuzues aty vërehet qartë se PSRK i referohet vetëm Ligjit për Rregullatorin e Energjisë elektrike Nr.05/L-185, përkatësisht nenit 35 par.4 të tij, të cilën gabimisht e citon, dispozita ligjore e cituar nuk përkon me dispozitën të cilën e citon PSRK në ankesë, pasi që citon ligjin i cili ka qenë i shfuqizuar në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale, ashtu që PSRK insiston në një qëndrim të gabuar duke mos e bërë dallimin në mesë aksioneve dhe asetëve.

Tutje ka shtuar se KQP ka pas për detyrë të bëjë transferimin e aksioneve dhe se në asnjë mënyrë objektivisht nuk mund të mbahet përgjegjëse për asetet e një kompanie që i nënshtrohet procesit të privatizimit. Nga administrimi i provave materiale: Vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe Vendimi i Kuvendit është vërtetuar se organet më të larta shtetërore kishin vendosë që pjesa e distribucionit të privatizohet. Prandaj, është më se e qartë se KQP kishte vepruar brenda mandatit që i është dhënë nga Qeveria e Kosovës.

PSRK duke ndjekur një linjë të palogjikshme të argumentimit po mundohet që të bindë Gjykatën e Apelit se anëtarët e KQP dhe udhëheqësja e NJIP kanë tejkalluar detyrat zyrtare edhe pse asnjë provë e vetme nuk e mbështet këtë qëndrim. Për mbrojtjen është shumë e çuditshme se si PSRK mundohet të argumentoj përgjegjësinë penale të menaxheres së NJIP znj. F.H.

NJIP ka qenë një sekretari e KQP-së pa mandate vendim-marrës, prandaj jo vetëm znj. F.H si udhëheqëse e NJIP, por edhe vetë ky sekretariat nuk kanë pas mandate vendim- marrës. Si ka mundësi që një punonjës - zyrtarë të tejkaloj detyrën zyrtare nëse ai nuk ka marrë çfarëdo lloj vendimi në kuadër të institucionit pjesë e të cilit është.

Për të akuzuarën F.H, PSRK edhe në ankesë nuk ka potencuar se cili akt juridik e detyronte atë të vepronte në mënyrën se si pretendon PSRK, respektivisht që të shfrytëzonte kompetencat e saja apo të vepronte konform detyrimit që të mos lejoj që të privatizohen hidrocentralet.

Përfundimisht, aktgjykimi lirues i gjykatës së shkallës së parë i përmbushë në tërësi kushtet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor sepse i njëjti tregon qartë dhe i plotë duke treguar qartë arsyet për gjetjet faktike dhe ligjin e aplikueshëm, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Gj, av. Flamur Bllacaku në përgjigje në ankesën e PSRK-së, ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se A.Gj në cilësinë e Drejtorit Menaxhues në KEK të gjitha veprimet e tij i ka kryer sipas autorizimeve zyrtare, gjë që të gjitha pretendimet e prokurorisë kanë qenë të pabazuara.

Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar provat dhe dëshmitë në mënyrë të drejtë dhe konform Kodit dhe procedurës penale duke trajtuar me objektivizëm lëndën. Ka shtuar se mbrojtja gjatë gjithë procesit gjyqësor ka dorëzuar si dhe ka sqaruar faktet të cilat janë lehtë të argumentueshme dhe ligjore për kundërshtimin e aktit akuzues, pasi që i njëjti ka qenë i pathemeltë dhe i pabazuar. Andaj të cekurat në ankesë e PSRK-së, janë të njëjtat pretendime që gjykata e shkallës së parë i ka hudhur si të pabazuara ndaj A.Gj për të cilat është vërtetuar saktë se me asnjë veprim të tij nuk ka renë ndesh me dispozitat ligjore, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

4. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë si dhe përgjigjet në ankesë të

mbrojtëseve të akuzuarve, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se: **ankesa e Prokurorisë Speciale nuk është e bazuar.**

4.1. Të gjetura për pretendimet për shkelje të dispozitave të procedurës penale

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, edhe pse prokurori në ankesë nuk i'u referohet specifikisht ndonjë dispozitë për shkelje esenciale në përmbajtjen e ankesës. Kolegji çmon se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ekzistojnë kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret.

Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit janë të paqëndrueshme për faktin se organi akuzës nuk ka potencuar apo vërtetuar në mënyrë të duhur se cili akt ligjor apo nënligjor është shkelur.

Në këtë kontekst organi akuzës ka bërë referenca të gabuara ligjore për arsye se Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Elektrike, respektivisht nenin 35 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-084, nuk ka qenë në fuqi në kohën për të cilën prokuroria pretendon se të akuzuarit kanë kryer veprën/veprat penale pasi që Ligji në fjalë është ligj i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2016, dhe se në kohën për të cilën akti akuzues i ngarkon të akuzuarit (viti 2013), pra ky ligj nuk ka qenë në fuqi, në fakt as që ka qenë i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Argumenti ankimor se prokuroria është thirrur në dy ligje pasi ka konsideruar se vepra penale është kryer në mënyrë permanente, dhe se këto dy ligje si ai që ka qenë në fuqi si ligji i më vonshëm kanë përmbajtje të njëjtë, meqenëse kanë rregulluar çështjen e posedimit të licencave. Një interpretim të tillë Kolegji e konsideron si të pabazuar, për faktin se të akuzuarit akuzohen për veprimet të ndërmarra më 8 maj 2013, pasi me këtë datë kanë votuar që hidrocentralet të cilat prodhojnë energji elektrike si: hidrocentrali “Lumbardhi”, hidrocentrali “Burim”, hidrocentrali

“Radavci” dhe hidrocentrali “Dikance”, të transferohen tek KKDFE dhe më pas të privatizohen nga kompania “L - Ç”.

Po ashtu e akuzuara F.H, akuzohet pikërisht për faktin se ka qenë në njohuri të plotë për hidrocentralet se nuk duhet të privatizohen, të njëjtat janë të dhëna me koncesion dhe deri në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes me datë 8 maj 2013, nuk ka vepruar konform detyrave të veta, për më tepër ka dhënë pëlqimin që një veprim i tillë të ndodhë.

I akuzuari A.Gj akuzohet se nga pozita zyrtare që mbante, nuk ka ndërmarr veprime që hidrocentralet të mbesin pronë e KEK, që ndërlidhet me datë 8 maj 2013, kur është nënshkruar Marrëveshja për Importe, Marrëveshja për Transferim, Marrëveshja për Furnizim, Marrëveshja për Implementim, Marrëveshja për Borxhe.

Në këtë relacion, aktakuza ka të bëjë me veprimet inkriminuese të cilat sipas akuzës kanë ndodhur me datë 8 maj 2013 dhe para kësaj date për dy të akuzuarit e fundit të përmendur më lartë. Veprimet e të gjithë të akuzuarve janë të përcaktuara dhe kornizuara në dimensionin kohor, mbi bazën e këtyre fakteve ligji i cili duhet të zbatohet është ligji i cili ka qenë i aplikueshëm dhe jo ligji i mëvonshëm i cili tek në vitin 2016 është dekretuar dhe është bërë i zbatueshëm, rrjedhimisht, në një situatë të tillë nuk mund të i'u atribuohet detyra dhe përgjegjësi të akuzuarve që burojnë nga një ligj i cili nuk ishte në fuqi.

Kolegji çmon se gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

4.2. Të gjeturat për pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me pretendimin se arsyetim i aktgjykimit të ankimuar është joprofesional, sepse kjo gjykatë ka poseduar me të gjithat shkresat e lëndës dhe në ato shkresa kanë qenë edhe dokumentet siç është Kodi i etikës dhe mirësjelljes i cili buron nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili ka përshkruar edhe të drejtat dhe përgjegjësit e anëtarëve të Komitetit Qeveritar të Privatizimit (KQP), ku njëra nga përgjegjësit kryesorë ka qenë shqyrtimi dhe aprovimi i të gjitha dokumenteve përfundimtare të projektit përfshire edhe termet e referencës

si dhe aprovimin e të gjitha dokumenteve që lidhën me privatizimin e KKDFE-së dhe nënshkrimet e kontratave për shitjen e aksioneve me kompaninë e përzgjedhur gjë që nuk ka ndodhur nga ana e anëtareve të komisionit.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit nuk janë të bazuara. Nga faktet dhe provat e çështjes konstatohet se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në këtë aspekt faktet relevante nuk kanë mbetur të pavërtetuara sikurse pretendohet në ankesën e ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë administroi në shqyrtimin gjyqësor korpusin e provave të cilat konstatojnë faktet e rëndësishme në këtë çështje penale si: Kërkesat ligjore të kërkuara nga vepra penale për të cilën të akuzuarit janë të akuzuar; faktet e provat të cilat kanë vërtetuar pretendimet e gjetura nga gjykata, analizën e ekspertizës financiare të parashtruara nga organi akuzues si dhe provat e shkresat e tjera të lëndës.

Në këtë çështje penale konstatohet se privatizimi i afarizmit të KEK, respektivisht privatizimi i KKDFE/KEDS dhe atë para privatizimit i kanë paraprirë procese si legjislative e po ashtu edhe procese jo-legjislative, procese të organeve përgjegjëse për privatizimin e kësaj kompanie. Në kohën e privatizimit të aksioneve/afarizmit të KKDFE/KEDS, ka qenë në fuqi Ligji për Ndërmarrjet Publike L.nr.03/L-087 i vitit 2008.

Ky ligj ka përcaktuar se si dhe nën çfarë kushte mundë të privatizohet një ndërmarrje publike; Vendimi 04/36 i datës 17 shtator 2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin vendim është kërkuar shthurja e KEK, ku është bërë ndarja-shthurja e Divizionit të Distribuimit e Furnizimit nga Divizioni i Prodhimit.

Me këtë vendim është kërkuar që të bëhet ndarja e Distribuimit e Furnizimit me qëllim të krijimit të një subjekti të ri KKDFE/KEDS (ndërmarrje të re publike); Vendimin Nr.04/36 i datës 17 shtator 2008, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar data 31 mars 2009, si afat përfundimtar i shthurjes së KEK; vendimin Nr.03/38 të datës 2 tetor 2008, me të cilin vendim Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar privatizimin e KKDFE/KEDS në harmoni me nenin 9 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe ka ngarkuar Sekretarin e Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit, që vendimin për fillimin e procedurave të privatizimit të KKDFE/KEDS t'ia procedojë për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës; Vendimi i Kuvendit të Republikës së

Kosovës, Vendimi Nr.03-V-074 i datës 12 dhjetor 2008, me të cilin vendim Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka mbështetur privatizimin e distribuimit dhe shpërndarjes; Vendimin Nr.08/39 të datës 8 tetor 2008, me të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës, ka formuar KQP të parë (Komitetin Qeveritar për Privatizim) në përbërje me ministrat: A.Sh; L.Zh; J.P; N.R dhe M.J; Regjistrimi i KKDFE/KEDS në regjistrin e biznesit me numër 70606119 në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregëtisë e Industrisë, ku nga ky formularë shihet se veprimtari e KKDFE/KEDS është prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike. Ky regjistrim është bërë me datë 11 shtator 2009.

Në vitin 2009, regjistrimi i KKDFE/KEDS është bërë si kompani me asetet të cilat janë përcaktuar e regjistruar në emër të kësaj kompanie me rastin e shthurjes.

Në kuadër të aseteve, të cilat janë regjistruar dhe i kanë takuar kompanisë KKDFE/KEDS, kanë qenë edhe pesë hidrocentralet objekt shqyrtimi i aktit akuzues dhe i këtij aktgjykim; Vendimin Nr.02/04 i dt. 11 mars 2011, me të cilin vendim Qeveria Republikës Kosovës ka emëruar KQP e re (Komitetin Qeveritar të Privatizimit pas ndryshimit të përbërjes së Qeverisë me ministra të rinjë) dhe atë në përbërje nga ministrat: B.Bj, M.K-L, B.H, N.R dhe D.G, ku Qeveria e Republikës së Kosovës, për të mbarëvajtur procesi i shthurjes së KEK dhe i privatizimit të afarizmit të KKDFE/KEDS, ka kontraktuar IFC (Këshilltarin Ndërkombëtar të Transaksionit) si dhe ka pasur mbështetje nga Deloitte e TetraTech të angazhuar nga USAID.

Krijimin e kompanisë së re pas shthurjes dhe transferin e aseteve të saj, duke përfshirë edhe hidrocentralet në fund të procesit të janë aprovuar/miratur nga ZRRE (Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike); KQP me datë 8 qershor 2012, ka bërë hapjen e ofertave të ofertuesve dhe bazuar në kriterin e çmimit më të lartë të ofertuar ka zgjedhur ofertuesin “L.Ç” dhe ky proces i hapjes së ofertave është bërë nën prezencën e përfaqësuesve ndërkombëtar dhe organizatave ndërkombëtare të përfshira në këtë proces.

Vendimin Nr.04/78 me datë 12 qershor 2012, Qeveria Republikës së Kosovës ka miratur raportin e KQK mbi përzgjedhjen e ofertuesit “L.Ç” si kompani ofruese me çmimin më të shtrenjte; Shkresën Nr.073/13 me të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës ka informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës, për përmbushjen e kërkesave të Kuvendit të përcaktuara me vendimet e tij për shthurje dhe privatizim, ku Qeveria ka njoftuar Kuvendin për përzgjedhjen e kompanisë

ofertuese si ofruese e çmimit më të lartë; Shkresën Nr.2413 e datës 15 tetor 2012 me të cilën përfaqësuesi i IFC i ka prezantuar KQP, dokumentet finale kontraktuale, marrëveshjet të cilat i referohet dhe organi akuzës e eksperti në aktin akuzues.

Me datë 16 tetor 2012, NJIP njofton KQP se të gjitha materialet-marrëveshjet të cilat duhet të aprovohen nga KQP i janë nënshtruar diskutimit e aprovimit nga GQPE (Grupi Qeveritar për Energji) dhe me datë 13 shkurt 2013, NJIP i kërkon Bordeve Menaxhuese të KEK dhe KKDFE/KEDS që ti finalizojnë marrëveshjet për transferim, ku pas aprovimit nga bordet dhe nënshkrimit të tyre këto dokumente duhet të dërgohen për aprovim në KQP.

Vendimi Nr.502/2013, i datës 1 mars 2013, ZRRE ka aprovuar transferin e licencës së furnizimit publik dhe asetëve nga KEK në KKDFE/KEDS; Vendim Nr.503/2013 i datës 1 mars 2013, ZRRE me, ka aprovuar transferin e licencës.

Prokuroria Speciale akuzën për të akuzuarit e ka mbështetur në faktin se të akuzuarit në cilësi të personave zyrtar (anëtar të KQP, Menaxhere e NJIP e Drejtor Menaxhues në KEK), përkundër faktit se këto hidrocentrale nuk është dashur të transferohen dhe privatizohen, për arsye se një veprim të këtillë e ndalon baza ligjore, Ligji për Rregullatorin e Energjisë Elektrike Nr.05/L-084, neni 35 paragrafi 4, të njëjtat asetë kanë qenë nën koncesion si dhe rekomandimi i IFC ka qenë që të njëjtat të mbesin në kuadër të KEK dhe se hidrocentralet janë prodhim dhe nuk mundë të privatizohen në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartë-theksuara.

Kolegji vëren se nga kronologjia e shpjegimit të procesit të privatizimit, konstatohet se hidrocentralet historikisht i kanë takuar shpërndarjes dhe furnizimit e jo prodhimit, këtë fakt në dokumentin e saj e ka potencuar edhe IFC (se lista e asetëve është përgatitur nga KEK në bazë të listës historike të asetëve, të cilat kanë qenë pjesë e Divizionit të distribuimit të KEK, madje edhe para procesit të privatizimit”), nuk është vendosur nga të akuzuarit që këto asetë/hidrocentrale të jenë në shpërndarje e me qëllim të privatizimit të më vonshëm, pasi që kanë qenë pjesë e shpërndarjes.

Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimi ankimor i prokurorisë që njëra nga përgjegjësit kryesorë të anëtarëve të Komitetit Qeveritar i Privatizimit (KQP), ka qenë shqyrtimi dhe aprovimi i të gjitha dokumenteve përfundimtare të projektit përfshire edhe termet e referencës si dhe aprovimin e të gjitha dokumenteve që lidhën me privatizimin e KKDFE-së dhe nënshkrimet e

kontratave për shitjen e aksioneve me kompaninë e përzgjedhur gjë që nuk ka ndodhur nga ana e anëtareve të komisionit.

Kurse në anën tjetër i akuzuari A.Gj, në cilësinë e drejtorit menaxhues në KEK dhe e akuzuara F.H, në cilësinë e menaxheres së projektit për privatizimit NJIP e kanë ditur se këto asetë (Hidrocentrale) janë në listën e asetëve të distribucionit, dhe kanë qenë të obliguar që t'ua tërheqin vërejtjen organeve kompetente se ato nuk privatizohen dhe se të njëjtat është dashtë që të largohen nga kjo listë dhe të mbesin në KEK-se.

Kolegji, pajtohet me të gjeturat dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, se gjatë periudhës së ndërmarrjes së veprimeve nga ekzekutivi dhe legjislativi lidhur me privatizimin e distribuimit e furnizimit në raport me shthurjen e KEK dhe krijimin e subjektit të ri KKDFE, KQP me përbërjen prej të akuzuarve të kësaj çështjeje penale, nuk ka qenë e themeluar, çka nënkupton se të akuzuarit në cilësi të ministrave anëtar të KQP, nuk kanë qenë, pasi anëtarë të kësaj trupe janë emëruar shumë më vonë.

E akuzuara F.H, ka marrë detyrën e saj nga viti 2011, ndërsa i akuzuari A.Gj, në kohë kur asetet kanë qenë të determinuara në shpërndarje nuk ka qenë drejtor, sepse këto asetë që nga periudha më e hershme e para vitit 1999, kanë qenë pjesë e shpërndarjes.

Për rrjedhojë, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe trupa të tjerë kompetentë, për ta përmbushur mandatin e saj ekzekutiv dhe kërkesat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kanë ndërmarrë një sërë vendimesh/veprimesh, të cekura si në vendim e shkallës së parë. Kurse me vendimin nr.02/04 të dt.11 mars 2011, Qeveria Republikës Kosovës ka emëruar KQP e re në përbërje nga ministrat: B.Bj, M.K-L, B.H, N.R dhe D.G i cili vendim vë në pah se KQP e re e krijuar pas formatimit të Qeverisë, ka marrë mandatin e saj krejt pas përfundimit të procesit të shthurjes së KEK, pas përcaktimit të asetëve se cilat asetë do të transferohen në KKDFE, pas regjistrimit të KKDFE në regjistrin e biznesit si subjekt i ri, pas përcaktimit se cilat asetë do të takojnë KKDFE e në mesin e tyre edhe hidrocentralet, pas aprovimit të procesit të shthurjes e kalimit të asetëve nga KEK/Divizioni i Distribuimit e Furnizimit në KKDFE dhe pas miratimit të listave të asetëve dhe transferimit të tyre nga KEK në KKDFE (miratimit nga organet kompetente: Bordet Drejtuese të

Kompanive, ZRRE, etj), nga e gjithë kjo rrjedh se KQP e re e formuar, të gjitha këto procese i ka gjetur të përfunduara e duke përfshirë dhe përcaktimin e asetëve se cilat i takojnë KKDFE.

Në gjithë këtë proces NJIP, ka pasur rol teknik në mbështetje teknike të KQP, e jo se ka determinuar lista të asetëve apo ndarje asetesh gjatë shthurjes së KEK dhe sipas kërkesave të ekzekutivit, KQP ka vazhduar me procesin e privatizimit të KKDFE.

KKDFE ka qenë kompani vetëm se e krijuar dhe me asetet e saj, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka përcaktuar privatizimin e KKDFE me asetet e saj, KQP ka pasur mandat dhe detyrim që të udhëheqë procesin e privatizimit të KKDFE.

Gjykata e shkallë së parë ka dhënë arsye se me datë 12 qershor 2012, Qeveria Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.04/78 ka miratuar raportin e KQP mbi përzgjedhjen e ofertuesit “L.Ç” si kompani ofruese me çmimin më të shtrenjtë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë miratimit të raportit të KQP, nuk ka konstatuar ndonjë vërejtje e po ashtu asnjë vërejtje nuk është konstatuar edhe nga konsulentë ndërkombëtar e vëzhgues ndërkombëtarë, po ashtu Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk ka pasur vërejtje për procesin e privatizimit si dhe as për hidrocentralet të cilat kanë qenë pjesë e pakos së privatizimit.

Gjykata e shkallës së parë ka sqaruar se me datë 15 tetor 2012, përfaqësuesi i IFC me Shkresën Nr.2413, i ka prezantuar KQP, dokumentet finale kontraktuale, marrëveshjet të cilat i referohet dhe organi akuzës e eksperti në aktin akuzues, kurse me 16 tetor 2012, NJIP njofton KQP se të gjitha materialet-marrëveshjet të cilat duhet të aprovohen nga KQP i janë nënshtruar diskutimit e aprovimit nga GQPE (Grupi Qeveritar për Energji) dhe me datë 13 shkurt 2013, NJIP i kërkon Bordeve Menaxhuese të KEK dhe KKDFE që t'i finalizojnë marrëveshjet për transferim, pas aprovimit nga bordet dhe nënshkrimit të tyre këto dokumente duhet të dërgohen për aprovim në KQP.

Rrjedhimisht, të gjitha marrëveshjet që i referohet organi i akuzës si dhe eksperti, nuk janë të nënshkruara nga KQP as nga NJIP e Drejtori Menaxhues i KEK, këto dokumente janë të finalizuara e nënshkruara nga bordet drejtuese e më pastaj të miratuara nga KQP-së.

Pretendimi anikimor se të akuzuari me veprimet e tyre duke vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit kanë dëmtuar Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe KEK, njëkohësisht i kanë

dhënë mundësi përfitimi privatizuesit që pas përfundimi të koncesionimit këto hidrocentrale të kalojnë në pronësi të plotë të tij, janë pretendime të pa bazuara si të tilla nuk bazohen në faktet, rrethanat dhe provat e kësaj çështje penale.

Është e rëndësishme të trajtohet fakti se nuk mund të arrihet në përfundim që të akuzuarit me veprimet e tyre i kanë mundësuar tjetrit përfitim, duke mos cekur:

- a) se cilat janë ato veprime apo mos veprime të cilat i kanë ndërmarr apo nuk i kanë ndërmarr
- b) apo, cilat dispozita specifike të akteve ligjor apo nënligjore i kanë shkelur nga KQP, respektivisht të akuzuarit si anëtarë të KQP;
- c) cilat detyra zyrtare këta të akuzuar i kanë tejkalluar apo nuk i kanë përmbushur dhe se nga cili akt këto detyra kanë buruar.

Ndërsa në raport me të akuzuarën F.H, në cilësinë e Menaxheres së NJIP, e të akuzuarin A.Gj në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të KEK, nuk është përmendur se cili akt normativ i obligonte këta të akuzuar, që duheshin të vepronin në atë mënyrë si pretendon prokuroria, që të shfrytëzonin kompetencat e tyre apo të vepronin konform detyrimit që të mos lejojnë që të privatizohen hidrocentralet.

Pretendimi i prokurorisë se është dëmtuar Qeveria e Republikë së Kosovës dhe KEK rezulton i pa mbështetur në prova pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësi të aksionarit, nuk ka paraqitur asnjëherë pretendimin e ndonjë dëmi të shkaktuar me rastin e privatizimit të KKDFE/KEDS.

Pretendimi ankimor se në fazën e procesit të privatizimit ka hyrë vetëm shpërndarja-distribuími dhe furnizimi, e jo kapacitetet gjeneruese, ku bëjnë pjesë edhe këto katër hidrocentrale, prandaj këto hidrocentrale është dashtë të largohen nga lista e asetëve të shpërndarjes dhe furnizimit pas që të njëjtat kanë gjeneruar energji dhe të mbesin në KEK.

Kolegji vëren se lidhur me këtë pretendim, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat i mbështet edhe kjo Gjykatë, se asetet historikisht kanë qenë të distribuimit dhe furnizimit e jo të prodhimit, kanë kaluar në kompaninë KKDFE, vite më parë,

para se të krijohet apo të marrin mandatin të akuzuarit në KQP dhe se KKDFE me asetet e saja vetëm se ka qenë e krijuar, në fakt shthurja e KEK, vetëm se ishte bërë kur të akuzuarit marrin mandatin e tyre si anëtarë në KQP, asetet i kishin takuar distribuimit e furnizimit e kështu kalojnë edhe në KKDFE.

Kalimi i aseteve nga KEK në KKDFE, ishte bërë nga Bordet Menaxhuese të këtyre dy ndërmarrjeve publike si përfaqësues të aksionarit dhe atë me shthurjen e KEK, e jo nga KQP, NJIP apo Drejtori Menaxhues, prandaj pozicionimi i këtyre aseteve në furnizim e shpërndarje ishte bërë shumë më herët se këta të akuzuar të marrin pozitat e tyre në ekzekutiv apo ndërmarrje publike.

Dokumentet e privatizimit, posaçërisht listat e aseteve kanë qenë të hartuara mbi bazën e listave historike të KEK- të, hidrocentrale kanë qenë pjesë e distribuimit e furnizimit, një fakt të këtyre e potencon edhe IFC, në raportin e saj, dokumentet e privatizimit janë hartuar nga konsulentët e ndërmarrjet publike, janë konsultuar e diskutuar nga konsulentët, Bordet e ndërmarrjeve, GQPE e më pas janë aprovuar në KQP, ashtu që për këto asete, nuk është vendosur nga KQP që të njëjtat të kalojnë në KKDFE, ato kanë kaluar shumë vite përpara se të akuzuarit të marrin mandat në KQP.

Kolegji, po ashtu trajtoj edhe pretendimet e prokurorit se të akuzuarit duke vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit kanë dëmtuar Qeverinë e Republikë së Kosovës dhe KEK dhe njëkohësisht i kanë dhënë mundësi përfitimi privatizuesit që pas përfundimi të koncesionimit këto hidrocentrale të kalojnë në pronësi të plotë të tij.

Një pretendim i tillë mbetet i pa argumentuar, i pa mbështetur në prova konkrete se ishte qëllimi i të akuzuarve për t'i mundësuar përfitim kompanisë privatizuese ose për t'i shkaktuar dëm KEK, pasi që këto asete vite përpara kanë kaluar në KKDFE e jo nga ndonjë vendim i të akuzuarve, pra asetet shumë më herët se të akuzuarit të emërohen në KQP, kanë qenë në KKDFE, ndërsa kompania privatizuese "L.Ç" është zgjedhur vite më vonë si fituese.

Në referim të shpjegimeve të sipërcekura është jashtë logjike të konkludohet se ka ekzistuar qëllimi tek të akuzuarit për ta kryer veprën penale, derisa ata nuk kanë pasur asnjë impakt në

përgatitjen e aseteve për tu transferuar në KKDFE e me qëllim që më vonë ti shiten kompanisë privatizuese, e cila kur është bërë shthurja e KEK, në aspektin kohor, nuk është ditur se kush do të jetë fitues, si dhe faktin relevant se të akuzuarit në atë kohë nuk kanë qenë as anëtar të KQP, e disa prej tyre as ministra.

Është me rëndësi trajtimi i këtij pretendimi të prokurorit, se është i gabuar konstatimi i gjykatës se shkallës së parë se IFC ka trajtuar shitjen e hidrocentraleve si pjesë e aseteve të Divizionit dhe shpërndarjes KEK dhe në bazë të këtij konstatimi arrin në përfundim se IFC paska trajtuar hidrocentralet si asetet të shpërndarjes dhe atë si asete të transferuar në KEDS me miratim e ZRRE, pasi që IFC në asnjë moment nuk thotë se ka qenë në rregull që katër hidrocentrale që gjendjen në listën e aseteve të Divizionit të Shpërndarjes, por vetëm jep përshkrim të gjendjes aktuale se ku të njëjtat kanë qenë të vendosura.

Sipas prokurorit, fakti me i rëndësishëm i cili gjendet në shkresat e lëndës ndërlidhet pikërisht me IFC dhe raportet e tyre, rekomandimi në fjalë gjendet në faqen 33 par.2.6; "Janë edhe 4 hidrocentrale të vogla të cilat nuk janë të rëndësishme për KEDS dhe nuk do të transferohen, këto asete do të mbesin në KEK dhe kufiri komercial di të jetë pika matëse konektuese në bazë të rregulloreve të ZRRE".

Kolegji vëren se lidhur me këtë çështje ekziston një përgjigje e IFC e datës 13. 01. 2017, e dhënë nga Thomas Lubeck – menaxher Rajonal për Ballkanin Perëndimor, lidhur me këtë sqaron, "se ky nuk ishte një rekomandim nga IFC. MI në thelb ka përshkruar asetet e shpërndarjes dhe furnizimit siç ishin në kohën kur ishte përgaditur, dhe ka lënë hapësirë të mos përfshijë hidrocentralet të cilat në atë kohë ishin asete të shpërndarjes, nëse KEK-u do të donte të mbaj këto asete në pjesën e gjenerimit të biznesit të saj".

Ndërsa, për çështjen e hidrocentraleve bëhet fjalë po ashtu në dokumentin e titulluar - Private Sector Participation in Kosovo Power Distributin, Initial Due Diligence, Key Issues and Findings, February 2010, faqe 25, "Alokimi i hidrocentrale të vogla. KEK-u propozon që katër hidrocentrale (me një total prej 16 Mw) do të transferohen të KEDS, të cilat aktualisht janë asete të distribuimit, por të cilat operojnë nga palët e treta mbi bazën e kontratave dhe konscesionare. Njëra prej këtyre hidrocentraleve (Lumbardhi) ka licencë të prodhimit nga ZRRE. Të tjerat nuk posedojnë licencë për shkak se kanë kapacitete me pak se 5 Mw. Propozimi i KEK-ut, duket se është i pranueshëm. Ligji mbi Energjinë Elektrike dhe Projektligji për Energjinë Elektrike nuk i ndalon kompanitë e distribuicionit nga pronësia e këtyre aseteve. Legjislacioni ekzistues i energjisë ju jep përparësi burimeve të ripërtitshme të energjisë".

Gjykata e shkallës së parë i është referuar Dokumentit të IFC “Raporti Përfundimtar mbi Çështjet Kyçe/Faza e Post-privatizimit” në faqen 7 të tij në seksionin C, ka trajtuar shitjen e hidrocentraleve si pjesë e privatizimit të KKDFE/KEDS, ku ka theksuar se “katër hidrocentralet ishin në listën e asetëve të Divizionit të Shpërndarjes së KEK. Kjo listë e asetëve është shfrytëzuar për ti definuar asetet që do ti transferohen KEDS. Këto asete kanë qenë edhe pjesë e RAB të miratuara nga ZRRE”. Në aktgjykimin e ankimuar arrihet në konkluzion se nga raporti shihet qartë se IFC në dokumentet e saj ka trajtuar hidrocentralet si asete të shpërndarjes dhe atë si asete të transferuara në KEDS me miratimin e ZRRE.

Kolegji vëren se bëhet fjalë për raport post privatizimit, dhe fakti se si trajtohen hidrocentralet është i karakteri përshkruar tani mbi gjendjen e pas privatizimit dhe jo ndonjë veçori lidhur me trajtimin e vlerësimin e këtyre asetëve.

Megjithatë, pavarësisht shpjegimeve të më sipërme dhe interpretimeve, mbi një gjendje të tillë të fakteve të vërtetuara, thelbësore për përgjegjësinë penale dhe ekzistimin e tipareve të veprës penale për të cilën akuzohen është se nuk rezulton synimi kriminal i të akuzuarve që veprimet zyrtare ti kenë ndërmarrë me qëllimin që “L.Ç” ti mundësojnë përfitim material, apo që KEK-ut të shkaktoj dëm, pasi është konstatuar se të akuzuarit nuk kanë pasur ndikim në determinimin e asetëve të cilat do të privatizohen, por kanë ndërmarrë veprime brenda KQP e NJIP për privatizimin e KKDFE e cila atëherë vetëm se i kishte asetet e saj.

Në këtë aspekt, Kolegji rikujton që në aspektin e të provuarit të aspektit subjektiv - dashjes, varësisht nga specifikat çështjes mund edhe të nxjerret nga rrethanat faktike dhe objektive, të cilat shfaqin qëllimin e të akuzuarve për të përfituar ose dëmtuar, në kontekst të natyrës së veprës penale e cila është objekt shqyrtimi, forma e dashjes duhet të jetë direkte.

Megjithatë, në rastin konkret nga tërësia e fakteve dhe rrethanave objektive, dashja e të akuzuarve mbetet e paprovuar. Nuk derivon, nuk manifestohet në kuptimin e qëllimit kriminal, pretendimet për vërtetim të dashjes se të njëjtit kishin qëllim që fituesit të tenderit të privatizimit “L.Ç” ti mundësonin përfitim të kundërligjshëm, duke marrë parash faktet se asetet/hidrocentralet ishin tradicionalisht pjesë e Distribuimit, të përcaktuara më parë, të cilat ishin bërë në kohën kur të akuzuarit nuk ishin bartës të këtyre përgjegjësisve dhe se procesi i privatizimit kishte ndodhur tek vite më vonë në aspektin kohor. Kolegji është i mendimit se ekzistimi i këtyre rrethanave në unitetin e tyre, tregon pa dyshim se pretendimi që të ketë ekzistuar qëllimi dhe mendimi kriminal

mbetet në kuadër të nivelit hipotetik, nuk plotëson standardin e të provuarit që kërkohet për një proces penal.

Kolegji, pajtohet me pikëpamjen e prokurorit në ankesë në raport me pjesën e arsytimit të gjykatës, se të akuzuarit nuk kanë përfituar financiarisht asgjë nga ky proces, prandaj arsytimi i aktgjykimit në këtë aspekt është i panevojshëm, për faktin se në aktakuzë të akuzuarit nuk janë akuzuar se të kenë përfituar në këtë proces për veten e tyre.

Po ashtu, lidhur me pretendimin se ka marr pjesë dhe a ka votuar në takimin e KQP-së i akuzuari N.R, nuk dihet se ku e bazon gjykata këtë konstatim. Në raport me të akuzuarin N.R, gjykata ka potencuar faktin se ky i akuzuar në këtë takim (8 maj 2013) të KQP, nuk ka marrë pjesë fare, nuk ka prezantuar. Kolegji vëren se i akuzuari në deklarinë në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.10.2022 ka deklaruar, se nuk i kujtohet se ka qenë pjesë e votimit dhe përfundimisht ka deklaruar se nuk ka qenë prezent me datë 13. 05. 2013.

Kolegji rikujton se vepra penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 2 lidhur të KPRK-së, është vepër e natyrës blankete, e cila i referohet legjislacionit jo penal që përcakton kompetencat, autorizimet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve.

Është e rëndësishme të qartësohet se normat e natyrës blankete domosdoshmërisht duhet të jenë të natyrës ligjore (në kuptimin e zgjeruar përfshirë aktet nënligjore) dhe se konstatimet e IFC-Memorandumi i Informimit, nuk është dokument ligjor, rrjedhimisht, edhe në versionin se çfarëdo që mund jenë eventualisht konstatimet apo rekomandimet, nuk mund të jenë substitut (zëvendësim) të asnjë dispozite ligjore blankete për të atribuar zyrtarëve përgjegjësi ligjore, për më tepër një dokument i tillë konstatohet se është i natyrës së marketingut.

Prandaj, është e nevojshme që brenda kuadrit normativ ligjor veprimet inkriminuese të rezultojnë me shkelje të qëllimshme në aspektin subjektiv, në kuadër të kompetencave ndërmarrin veprime të cilat nuk janë në interesin e detyrës zyrtare të cilën e ushtrojnë, i tejkalojnë kompetencat dhe autorizimet apo nuk e kryejnë detyrën për të cilën janë të obliguar ligjërisht ta kryejnë. Të gjitha këto veprime duhet të merren të motivuara për të sjellë përfitim vetes, tjetrit apo që ti shkaktojnë dëm ose ti shkel drejtat tjetrit.

Kolegji gjithashtu dëshiron të tërheq vëmendjen, se ky është një proces penal dhe jo një proces i vlerësimit të ligjshmërisë administrative të procesit të privatizimit, për këtë arsye gjykata penale i trajton të rëndësishme vetëm faktet të cilat ndërlidhen me aspektin e përgjegjësisë penale dhe konsumimit eventual të tipareve të veprave penale.

Nga rrethanat e çështjes, rezulton se nuk është provuar se cili akt ligjor apo nënligjor është shkelur nga KQP, respektivisht të akuzuarit si anëtar të KQP, nuk janë identifikuar dhe potencuar se cilat detyra zyrtare konkrete i kanë tejkaluar apo nuk i kanë përmbushur dhe se nga cili akt ligjor apo nënligjor këto detyra derivojnë.

Për të akuzuarën F.H në cilësinë e Menaxheres së NJIP, e të akuzuarin A.Gj në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të KEK, nuk ceket se cili akt i obligonte këta të akuzuar që këta duhesh të vepronin në atë mënyrë siç pretendon prokuroria, respektivisht që të shfrytëzonin kompetencat e tyre apo të vepronin konform detyrimit që të mos lejojnë që të privatizohen hidrocentralet, nuk përshkruhen se cili akt ligjor apo nënligjor e kanë cenuar të akuzuarit;

ZRRE në përgjigjet e dhëna me datë 22 dhjetor 2016 dhe 24 nëntor 2020, ka shpjeguar se si janë transferuar asetet nga KEK tek KKDFE me rastin e shthurjes, e më pastaj se si këto asete kanë kaluar nga KKDFE tek privatizuesi i afarizmit të shpërndarjes dhe furnizimit, këto asete janë bërë nën pajtimin dhe vendimmarrjen e Kuvendit të Republikës, Qeverisë së Republikës, Bordeve të ndërmarrjeve publike e deri tek aprovimi i transferit të asetëve e licencave të shërbimit nga ZRRE. Në këtë kontekst në shkresën e dytë ka shpjeguar dhe llogaritjen e tarifave dhe të hyrave jo-tarifore, respektivisht se kush përfiton nga të hyrat jo-tarifore/qiraja.

Në shkresën e vitit 2016, ZRRE ndër të tjera ka theksuar se “sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, parashihen edhe raste kur operatori i sistemit të shpërndarjes është i integruar vertikalisht (që do të thotë psh. ka në operim ndonjë gjenerator, atëherë aplikohen dispozitat e ligjit si më poshtë ...)”. ZRRE vazhdon me përgjigjen se në harmoni me cilin ligj në fuqi në atë kohë si për energjinë elektrike dhe për ZRRE, ka aprovuar kërkesën për licencë për furnizim me energji elektrike dhe nën cilat kushte e ka aprovuar.

Ligji 03/L-185 për ZRRE (ligj në fuqi në kohën e privatizimit) dispozita e nenit 28, nuk obligon që të ketë licencë asnjë kompani gjeneruese për kapacitete nën 5 MW, që përfundimisht

konkludohet se edhe IFC e ZRRE, mendimet e tyre apo përgjigjet e tyre i kanë dhënë në harmoni me legjislacionin në fuqi në kohë, si atë për ZRRE e Ligjin për Energjinë Elektrike.

Pretendimi i prokurorisë se të akuzuarit me qëllim i kanë shkaktuar dëm KEK apo kanë krijuar përfitim kompanisë privatizuese “L.Ç”, në aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë konstaton, se në rastin konkret rezulton e paprovuar se i është shkaktuar dëm KEK apo përfitim KEDS/“L.Ç” dhe atë për faktin se nuk është vërtetuar se “L.Ç” ka përfituar nga privatizimi i hidrocentraleve, fakt i vërtetuar edhe nga IFC në raportet e saj, në raportin e Dhjetorit 2016 “Final Key Issues Report Kosovo Distribution and Supply Post Privatization Stage” ka theksuar se KEDS nuk është duke përfituar asgjë financiarisht nga këto asete.

KEDS/“L.Ç”, bazuar në raportin e lartë-theksuar të IFC ku ka dhënë sqarim lidhur me faktin se KEDS nuk ka asnjë përfitim nga këto asete, dhe atë duke theksuar:

“këto hidrocentrale mbahen nga entitete private dhe KEK-u ka nënshkruar marrëveshje afatgjate koncesionimi ose qiraje me operatorë privat, në bazë të cilave KEK-u ka marrë qira të vogla për çdo vit, ndërsa kompanitë private kanë pasur të drejtë që t’i gëzoj benefitet nga tarifat e dhëna për këto hidro-kapacitete. Me privatizimin të gjitha këto kontrata janë transferuar tek KEDS. Qiraja për këto hidro është zbritur/reduktuar nga MAR i KEDS, 100 përqind, andaj KEDS nuk është duke përfituar asgjë financiarisht nga këto asete”;

IFC në këtë pjesë të raportit, ka konstatuar “këto asete janë trajtuar si të gjitha asetet tjera të Divizionit të Shpërndarjes”. Procesi lidhur me transferimin e aseteve ka qenë tërësisht transparent. Këto asete kanë qenë pjesë e dhomës së të dhënave dhe transferi i tyre është miratuar përmes të njëjtit proces transparent sikur edhe të gjitha asetet tjera të Shpërndarjes. Vlera materiale e këtyre aseteve në kuptim të ndikimit të tyre në privatizim ka qenë minimale për shkak të qirave të ulëta, ndërsa ajo edhe ashtu i kthehet konsumatorëve të Kosovës në formë të tarifës”.

Nga ky konstatim i IFC, kuptohet se këto asete kanë vlerë minimale në privatizim dhe se vlera e qirave i kthehet konsumatorëve, që nënkupton se KEDS nuk përfiton asgjë nga këto qira, pasi që të njëjtat nuk i mban për vete por ato zbatohen në fatura të konsumatorëve.

Ndërsa ZRRE në Përgjigjen e saj nën numrin 426/20 të datës 24 nëntor 2020, konstaton se:

“OSSH nuk mundë t’i mbajë të hyrat e realizuara nga qiraja për hidrocentrale, përveç në rast që dëshmon që ka realizuar shpenzime për ato hidrocentrale dhe të cilat shpenzime nuk janë mbuluar nga ndonjë mekanizëm tjetër. Në rastin konkret, OSSH nuk ka mundur të dëshmoj për shpenzime që ndërlidhe me to, andaj ZRRE i kthen të gjitha ato të hyra përmes tarifave tek konsumatorët fundor me energji elektrike”. Nga përgjigje e ZRRE shihet se KEDS nuk ka asnjë përfitim nga këto qira dhe se këto qira kthehen tek konsumatorët fundor përmes tarifave.

Ndërsa transferimi i kontratave të qirasë nga KEK në KKDFE/KEDS është bërë me aprovimin e Bordeve të ndërmarrjeve, pasi këto asete i kanë takuar gjithnjë furnizimit dhe shpërndarjes dhe atë në komunikimet të cilat i kanë pasur Bordit të KKDFE e Bordi i KEK, kanë njoftuar NJIP se në mesin e dokumenteve të përgatitura për aprovim në KQP janë edhe marrëveshjet/kontratat mbi qiranë, ku dhe kanë prezantuar në listën e dokumenteve e marrëveshjeve të cilat do të transferohen edhe kontratat mbi qiranë e hidrocentraleve.

Rrjedhimisht, Kolegji, arrin në përfundim se në këtë çështje penale nuk është bërë identifikimi i dispozitave blankete konkrete ligjore, në bazë të cilave të akuzuarit do të ishin përgjegjës, dhe nga detyrat e tyre do të buronte obligimi që hidrocentralet të përjashtohen nga procesi i privatizimit. Nuk është faktuar, se cili akt ligjor apo nënligjor është shkelur nga të akuzuarit me rastin e pretendimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal

Sa i përket shkeljes e ligji penalë prokurori e cek vetëm si bazë ankimore ndërsa në ankesë nuk i referohet fare kësaj bazë, megjithatë kjo gjykatë gjënë se mbi bazën e vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se të akuzuarit B.B, M.K-L, N.R dhe D.G, e kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa e akuzuara F.H dhe i akuzuari A.Gj veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 2 KPRK-së, pasi që qartazi nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e veprës penale të cituar me lartë dhe as që kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese në dispozitiv që do të përbënin figurën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Faktet e tilla janë përcaktuese për veprën penale për të cilën akuzohet të akuzuarit, nuk mund të pretendohet për zbatim të duhur të ligjit material, përderisa nuk kemi një përshkrim të qartë e jo dubioz të identifikimit të saktë përgjegjësi, detyrave e kompetencave në normat ligjore të natyrës jo penale të cilat rregullojnë fushë veprimtarinë e caktuar, pastaj ndërlidhjen e domosdoshme e koherente me dispozitat e ligjit penal.

Prokuroria, bëri përpjekje të argumentoj se të akuzuarit B.B, M.K-L, N.R dhe D.G, duke qenë anëtarë të KQP në kryerjen e veprës penale veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK vepruan në bashkëkryerje në kuptim të nenit 31 të KPRK-së.

Bashkëkryerja - Neni 31 të KPK-së përcakton:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.

Akuza në kuptim të bashkëkryerjes, nuk mbështetet në prova konkrete për të provuar ekzistimin e marrëveshjes mes tyre dhe lidhjes objektive dhe subjektive, përveç faktit se kanë vepruar së bashku brenda një kuadri institucional - Komitetit Qeveritar të Privatizimit të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, të përcaktuar me vendim të Qeverisë në funksion të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë vendim.

Një fakt i tillë pa ekzistimin e dëshmive të qarta, në kontekst të bashkërendimit të aktiviteteve të tyre të qëllimshme kriminale, duke shfrytëzuar autorizimet brenda kornizës institucionale është natyrshëm i pamjaftueshëm për të arritur në përfundimin se vepruan në bashkëkryerje.

Kolegji, dëshiron të qartësoj edhe versionin më relativ të kësaj forme të bashkëpunimit të personave në kryerjen e veprës penale, pa ekzistimin e një marrëveshje eksplicite para kryerjes së veprës penale. Për të konkluduar ekzistencën e marrëveshjes, mjafton që veprimet e bashkëkryesve të jenë të bashkërenduara gjatë kryerjes së veprës penale, në rastin konkret qartazi ekziston mungesa e provave apo dëshmive për të konfirmuar bashkërendimin e veprimeve të akuzuarëve.

Duke pasur parasysh shpjegimet e lartcituara mbi gjendjen tillë të fakteve, aplikimi i ligjit penal është i drejtë dhe nuk ka mundur të ketë alternativë tjetër të aplikimit të ligjit penal.

Gjithashtu aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

5. Përfundimi

Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin e arsyeshëm se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale, për të cilat janë akuzuar, për rrjedhojë me të drejtë të akuzuarit janë liruar nga akuza për veprat për të cilën janë akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

DEPARTAMENTI SPECIAL

APS.nr.7/23

Datë: 27.03.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Burim Ademi

Ferit Osmani
